



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM

Nr. 16, Datë 18 / 03 / 2008

Për

disa shtesa dhe ndryshime në Listën Paraprake të Pronave të
Paluajtshme Publike
që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë të Korçës.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës, në bazë të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” Neni 32, V.K.M. Nr. 500, datë 14.08.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, Ligjit Nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” dhe Ligjit Nr. 8744, datë 22/02/2001 “Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

VENDOSI:

1. Të ndryshohet funksioni i Dyqanit të Luleve nga dyqan lulesh në Zyra të Bashkisë Korçë, ky objekt mban nr. rendor 957 në inventarin e pronave të paluajtshme publike të Bashkisë Korçë.
2. Të shtohen në listën e pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen të transferohen në pronësi të Bashkisë Korçë, objektet si më poshtë vijon:
 - a) Reparti Mekanik ndodhur në U.M.B. Korçë. Bashkisë Korçë i është njohur e drejta e përfaqësuesit të pronarit me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 13.01.2000 (nr. rendor 958).
 - b) Parku automobilistik, në krah të majtë të rrugës Korçë – Bilisht (nr. rendor 959).

- c) Ish – prona të Ndërmarrjes Artistike (nr. rendor 960).
 - d) Ndërtesë në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike me numër pasurie 3/12, Zona Kadastrale 8561(nr. rendor 961).
 - e) Konvikti i shkollës së Ndërtimit (nr. rendor 962).
 - f) Objekt i administruar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, ndodhur në kat të dytë të Atelisë (nr. rendor 963).
 - g) Infrastrukturë vendore dhe shërbime publike (nr. rendor 964)
 - h) Objekti dhe ambientet ndihmëse të Senatoriumit Korçë (nr. rendor 965).
- 3. Paraqitjen e shtesave në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike, për miratim në Këshillin e Ministrave.
 - 4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave Publike dhe Tokës.
 - 5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Raimonda Nese
KRYETARI
RAIMONDA NASE